



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0517

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) NTP " BENI ", kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KOMUNA SUHAREKË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi-mirëmbajtja me material higjieno sanitar për nevojat e shkollave dhe QKMF-ve dhe QMF-ve me numër të prokurimit 624-23-4977-1-1-1, me 24/11/2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet pjesërisht**, si e bazuar ankesa e OE NTP " BENI " me nr. 2023/0517 , e datës 24/07/2023, kurse vendimi i AK KOMUNA SUHAREKË lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi-mirëmbajtja me material higjieno sanitar për nevojat e shkollave dhe QKMF-ve dhe QMF-ve me numër të prokurimit 624-23-4977-1-1-1 **mbetet në fuqi.**

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik NTP " BENI "

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 06.06.2023, Komuna e Suharekës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar për njoftimin kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi-mirëmbajtja me material higjieno sanitar për nevojat e shkollave dhe QKMF-ve dhe QMF-ve" me nr. të prokurimit: 624-23-4977-1-1-1.

Me datën 07. 07. 2023, AK ka publikuar njoftimin B58 për dhënie të kontratës OE "Samire Elshani" B.I me çmimin më të ulët të peshuar 2.5 euro.

OE NTP "Beni" me datën 12.07.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 14.07.2023, AK - Komuna Suharekë me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues NTP "Beni", me datën 24.07.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0517, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

- Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nën paragrafin 75 të LPP.

Lidhur me këtë, me 04. 08. 2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa të refuzohet si e pabazuar;
- Të mbetet në fuqi vendimi i AK

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale ku AK është pajtuar me mendimin e ekspertit, ndërsa operatori ekonomik ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues NTP "Beni" janë parashtruar si në vijim:

- *Pretendimi i parë (I)-* Ne mënyrë të kundërligjshme ka rekomanduar për kontrate Operatorin Ekonomik të pa përgjegjshëm i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e AK-se të vendosura në Njoftim për Kontratë (NJK) dhe dosje të tenderit(DT). Nuk e plotëson këtë kërkesë pasi që nuk ka ofruar kurrfarë liste dhe nuk ka prezantuar asnjë kontratë të furnizimit të natyrës së kontratës ndërsa AK ka kërkuar që OE duhet të ofroj furnizime në vlerën prej 238,000.00€ ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar këtë kërkesë të AK-së dhe është dashur të eliminohet. Nuk e plotëson këtë kërkesë pasi që neve nuk na kane lejuar qasje në mostrat e OE të rekomanduar për kontratë me arsyetimin se janë sekret afarist ku për here të pare po dëgjojmë se mostrat qenkan sekret afarist, është për çudi se ligji dhe rregullorja e përcaktojnë që për sekrete afariste mund të plotësohet kërkesa për sekret afarist nga sistemi Aneksin 3 të dosjes së tenderit ku behet fjale vetëm për dokumente pra një OE mund ta plotësojë kërkesën për sekret afarist vetëm për dokumente e jo edhe për mostra pasi që mostrat janë me shifra dhe askush nuk duhet të dije se cilat mostra cilit OE i përkasin, nëse AK i ka

ndare ato mostra nga mostrat tjera ka bere shkelje te ligjit dhe te rregullores 001_2022 te KRPP-se. Gjithashtu OE fitues e ka qit ne lajthitje AK sepse ne paramase ka ofertu me çmime te rrejshme, çmime ekstreme te lira, si psh tek pozicioni nr.27, sepse ne këtë produkt e prodhojmë dhe e dimë se sa kushton. Vetëm amballazha e këtij produkti kushton me shumë se çmimi i ofertuar nga OE fitues me çmim 0.24 euro, i cili ky çmim është çmim manipulues i fituesit. Siç po shihet nga më sipër ky OE është dashtë te eliminohet e jo te shpërblehet me kontrate pasi qe ka ofertuar me tender te pa përgjegjshëm ku nuk i ka plotësuar asnjë kërkesë te AK-se te vendosur ne NJK dhe DT. Ne mënyrë te kundërligjshme AK na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne Njoftim për Kontratë (NJK) dhe dosje te tenderit(DT). Ndërsa ne vendimin për refuzim te datës 14.07.2023, te kërkesës tone për rishqyrtim AK nuk ka dhënë kurrfarë arsytimi vetëm se sipas komisionit të vlerësimit e posedon listën e kontratave dhe referencave pa na dëshmuar se cilat janë ato.

- *Pretendimi i dytë (II)*- Ne mënyrë te kundërligjshme AK na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne Njoftim për Kontratë (NJK) dhe dosje te tenderit(DT). AK na ka eliminuar kundërligjshëm me arsyetimin se: 2.1 nuk kemi referenca sipas kërkesës se AK-se ne vlere prej 51% dhe 2.2 Te përshkrimi i çmimeve ne paramase është përdorur dy e me shume numra pas presjes dhjetore e cila nuk lejohet sipas rregullores 001/2022 për prokurim publik 17.11. Neve e kemi prezantuar listën e furnizimeve sipas kërkesës se AK-se ku vetëm me pastrimin e qendrës se studenteve kemi bere furnizimin me material te njëjtë jo te ngjashëm gati dyfish ne vlerën e kërkuar nga AK për te cilën e kemi sjelle kontratën referencën dhe mund te ju sjellim edhe raportet e pranimit te materialit nëse keni dilema. Por nuk keni çka te keni dilema sepse pastrimi i hapësirave nuk mund te behet pa material. Dhe po ashtu kontratat e prezantuara dhe referencat e NPT BENI Liderit te GOE arrin vlerën mbi 1,400 000.00 Euro dhe janë te natyrës se njëjtë. Ndërsa ne vendimin për refuzim te datës 14.07.2023, te kërkesës tone për rishqyrtim AK thotë se keni ofruar vetëm kontrata te pastrimit jo te furnizimit me material pra lind pyetjes si është e mundur të pastrohet pa material higjenik? Neve i kemi flete dërgesat e materialit komplet për këtë kontrate dhe faturimin e këtij materiali dhe pagesat nga Autoriteti Kontraktues. AK na ka eliminuar se Te përshkrimi i çmimeve ne paramase është përdorur dy e me shume numra pas presjes dhjetore e cila nuk lejohet sipas rregullores 001/2022 për prokurim publik 17.11. por ne këtë nen thuhet kështu: “17.11 Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Nëse OE ofron çmim me shumë se dy (2) numra pas pikës dhjetore, oferta e tille do të konsiderohet e papërgjegjshme. Në rast se AK lejon çmime me më shumë se (2) numra pas pikës dhjetore, atëherë AK një informatë të tillë duhet ta përcaktoj në dosjen e tenderit dhe duhet të përdorë Listën e çmimeve jo-standarde”. Ndërsa AK ne dosje te tenderit ka parapare ne faqen 7 te dosjes se tenderit: 20. Valuta dhe Kalkulimi i Çmimit: "20.1 Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€) dhe duhet të përfshijnë dhe specifikojnë të gjitha taksat e aplikueshme, detyrimet dhe pagesat tjera. Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas presjes dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të dytë (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës". Siç po shihet vet AK ne dosje te tenderit ka parapare qe nëse shënohen me shume numra se dy pas presjes dhjetore nuk do te llogariten e jo te eliminohet një OE, pra AK po bie ne kundërshtim me kërkesat e veta te vendosura ne NJK dhe DT. Gjithashtu ne kemi plotësuar vetëm pjesën tonë qe na takon ku kemi vendosur çmimet ne kolonën e çmimeve te paramases se AK, ndërsa te kolona çmimi i peshuar ne nuk kemi ndërhy, ato janë kalkuluar sipas formulës se juaj, shiqo paramasen. Ndërsa ne vendimin për refuzim te datës

14.07.2023, te kërkesës tone për rishqyrtim AK nuk ka dhënë kurrfarë arsytimi. Neve jemi te vetmit qe kemi ofertuar me tender te përgjegjshëm dhe me Çmimin me te ulët.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues për ankesën 517/23

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se AK-ja, kryesisht nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 59 te LPP-se dhe njëherit pretendon se nuk qëndrojnë arsyet e eliminimit te ofertës tone.

- *Konstatimi i parë (I)*- OE ankues, eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se: 2.1 nuk kemi referenca sipas kërkesës se AK-se ne vlere prej 51% dhe 2.2 Te përshkrimi i çmimeve ne paramase është përdorur dy e me shume numra pas presjes dhjetore e cila nuk lejohet sipas rregullores 001/2022 për prokurim publik 17.11. Sa i përket arsytimit te AK-se se OE ankues nuk e plotëson kërkesën e dosjes lidhur me kontratat dhe referencat, eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron ky arsyetim i AK-se, sepse OE ankues ka ofruar ne listën e kontratave mjaftueshëm kontrata dhe referenca te cilat e mbulojnë kërkesën e AK-se. Eksperti shqyrtues ne veçanti e analizon piken e dyte te eliminimit te OE ankues, lidhur me vendosjen e dy e me shume numrave pas presjes dhjetore, ku OE ankues pretendon se AK-ja, ne faqen nr. 7 te dosjes se tenderit ka dhënë sqarimin: 20.1 Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€) dhe duhet të përfshijnë dhe specifikojnë të gjitha taksat e aplikueshme, detyrimet dhe pagesat tjera. Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas presjes dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të dytë (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës. Pra, sipas OE ankues nuk do te llogariten e jo te eliminohet një OE. Eksperti shqyrtues lidhur me këtë pretendim vlerëson se nuk qëndron pretendimi i OE ankues, sepse ne faqe nr. 7 është vetëm sqarim dhe nuk ka te beje me atë çfarë pretendon OE ankues, sepse edhe po të merrej për baze pika 20.1 e faqes nr. 7 te dosjes se tenderit prape OE ankues do duhej te shpallej i papërgjegjshëm, sepse ne pozicionin nr. 1, 3, 4 dhe shume pozicione te tjera ka dhënë këto çmime:
- Ne rastin konkret, saç pretendon OE ankues qe sipas pikës 20.1 te dosjes se tenderit te mos llogariten dy numrat pas presjes dhjetore, atëherë këto pozicione rezultojnë me 0.00. Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se me te drejte AK-ja e ka eliminuar OE ankues lidhur me çmimet e dhëna ne paramase sepse një gjë e tille është sanksionuar ne nenin 17.11 te Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022.
- *Konstatimi i dytë (II)*- OE ankues ne ankesën e tij pretendon se i rekomanduari për kontrate, nuk e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit lidhur me kontratat dhe referencat, ku AK-ja ka kërkuar: Kërkesa 1 - Projektet te ngjashme te natyrës së kontratës te realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e te gjitha projekteve të natyrës se kontratës duhet të jetë jo ma e vogël se 238.500,00 €. Në rast të krijimit të konsorciumit, OE bartës duhet të plotësojë minimum 51 % kërkesave ekonomiko financiare dhe teknike e profesionale të referencave të natyrës së kontratës DHE dëshmi për përfundimin me suksese te këtyre projekteve. Në rast se OE ka realizuar kontrata me blerës privat, konform RRUOPP-së duhet të sjellë edhe dëshmitë e transaksioneve për këto projekte; Dëshmia 1 – Te dorëzoni listën në origjinal e vulosur dhe nënshkruar, të projekteve të ngjashme të realizuara ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate, dhe dëshmitë e përfundimit .Referencat për pranimin e mallrave. ksperti shqyrtues, pas ekzaminimit te listës se kontratave, sqaron se ne listën e kontratave te OE te rekomanduar për kontrate, me nr. rendor 12, ka ofruar një kontrate/reference me titull: Furnizimi me material dezinfektues për shkollat e Komunës se Prizrenit, ne vlere prej:

280,430.00 euro. Eksperti shqyrtues vlerëson se i rekomanduari për kontrate e ka plotësuar kërkesën e cituar me larte sepse produktet e dezinfektimit, bëjnë pjese te materiali hixhieno-sanitare. Prandaj, ky pretendim i OE ankues nuk qëndron. OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontrate nuk e ka plotësuar kërkesën e AK-se për ISO standardet, ku sipas OE ankues ka ofruar ISO standarde për DDD. Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja ne dosje te tenderit ka kërkuar: Kërkesa 2 - OE duhet te jete i licencuar me Iso Standarde për furnizim si a) Sistemi i Menagjimit te Cilësisë Iso 9001 2015 dhe b) Sistemi i Menagjimit te Sigurisë dhe Shëndetit ne Pune Iso 45001 2018 c) Sistemi i Menagjimit te Mjedisit 14001 2015; Dëshmia 2 - Certifikatat me validitet për Iso 9001 2015 , 45001 2018 dhe Iso 14001 2015. OE ankues ne ofertën e tij OE i rekomanduar për kontrate i ka dorëzuar ISO standardet sipas kërkesës se cituar me larte dhe nuk qëndron pretendimi se ka dorëzuar vetëm për shërbime DDD, sepse ne ISO standarde e dorëzuara thuhet edhe për tregtim te produkteve dezinfektuese dhe biocideve. OE ankues, pretendon se AK-ja, nuk e ka respektuar rregulloren për prokurim publik sepse AK-ja nuk e ka lejuar ne qasje me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontrate ka kërkesë për sekret afariste dhe ne te njëjtin pretendim e përmend faktin se OE ka ofruar çmime Jo/Normalisht te ulëta, konkretisht ne pozicionin nr. 27 i rekomanduari për kontrate ka ofruar çmim: 0.24 cent, ndërsa nuk e përmend faktin se si ka arritur ta shoh ketë çmim përderisa OE i rekomanduar për kontrate ka kërkesë për sekret afarist. Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne nenin 61 te LPP-se, vlerëson se është e drejte e AK-se ti vlerësojë çmimet dhe ne rastin konkret AK-Komuna e Suharekës nuk e ka vlerësuar si çmim jo/normalisht te ulet. Prandaj, ky pretendim nuk qëndron. Sqarim shtese: Lidhur me sekretin afariste, me datën: 30.07.2023, ka reaguuar edhe OE i rekomanduar për kontrate, i cili përveç argumenteve te veta te dhëna për pretendimet e OE ankues, ka deklaruar: Grupi i Operatoreve Ekonomike qe ka bere ankese N.T.Sh “Beni”; Krasniqi Shpk përveç qe janë te papërgjegjshëm dhe me çmim te larte se krejt OE ofertues ne si Operator Ekonomike kemi edhe dyshime tonat se si ky Grup Operatoreve Ekonomike paska pasur qasje ne dokumentet tona sekrete afariste si psh: i referohet Certifikatave Iso Standarde duke përmendur ne mënyrë decidive edhe për veprimtarit qe jam certifikuar por poashtu ne Kërkesën për Rishqyrtim paska përmendur qe pozicioni me numër rendor 27 është çmim ekstrem i lire ndërsa çuditërisht ne Ankesën ne OSHP-e paska përmendur tani ne mënyrë decidive qe për pozicionin me numër 27 paskam aplikuar me çmim te lire 0,24 euro .E informoj OSHP-ne se si është e mundur te këtë qasje ne këto dy te dhëna ky GOE e sidomos për Iso Standarde qe janë sekret Afarist pasi qe për këtë e kemi kontaktuar edhe AK ku kane deklaruar me përgjegjësi te plote qe GOE i është lejuar qasja ne dokumente zyrtare përveç atyre çka janë Konfidenciale dhe për AK ka bere klasifikimin e dokumenteve ku i është lejuar qasje këtyre GOE andaj ne si OE kemi dyshimet tona qe përmes rrugëve tjera ka mundur ky GOE te këtë qasje pasi qe dyshimi jone është i bazuar dhe krejt dyshimet tona i kemi qe pronari I N.T.SH “BENI” është person me ndikim te madh dhe rrethi familjar i këtij pronari te biznesit ka qasje drejtpërdrejt ne mbikëqyrjen e sistemit te Prokurimit Publike ne Kosove andaj edhe nëse janë marruar certifikata Iso Standarde prej ndonjë aktiviteti tjetër te prokurimit apo këtij te tanishmit ku kam aplikuar ju deklaroj me përgjegjësi te plote qe çdo here paraqesë Kërkesën për Konfidencialitet dhe nëse janë marrur e qe është dyshim shume i bazuar atëherë kemi te bëjmë me shkelje flagrante te LPP-se dhe kjo shkelje nuk duhet te heshtet nga OSHP-ja. Kërkojë ndërmarrjen e masave ne mënyrë qe pretendimet tona te vërtetohen. Besoj ne profesionalizmin e vlerësimit te kësaj ankese nga eksperti i lendes e poashtu edhe nga vendimi i bordit te OSHP-se. Ju falënderoj për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin e treguar!

Gjetjet dhe konstatimet e Panelit Shqyrtues

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportet e ekspertëve, parashtresat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit dhe vlerëson se ankesa e OE “Beni” aprovohet pjesërisht si dhe në bazë të pretendimeve të paraqitura e njëjta nuk ka arritur të ndryshojë epilogun e vendimit andaj rrjedhimisht vendimi i AK-së mbi dhënien mbetet në fuqi.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit si dhe konsideron se veprimet dhe aktet e AK dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetin e prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bje ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Paneli Shqyrtues konsideron se rrjedha e aktivitetit të prokurimit, në përgjithësi karakterizohet në përputhje me dispozitat ligjore, përveç eliminimit të ankuesit nga ky aktivitet.

Nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit, është gjetur se pretendimet ndaj të rekomanduarit për kontratë janë të pa bazuara ndërsa ndaj eliminimit të ankuesit pjesërisht të bazuara, por që nuk ndikojnë në ndryshim të epilogut përfundimtar të ankesës për faktin se edhe sikurse OE ankues të klasifikohet si i pasuksesshëm, kjo nuk do të ndryshonte epilogun përfundimtar duke qenë se OE ankues ka ofertuar me çmim më të lartë se OE i rekomanduar.

Vlen të theksohet se elementet kyçe përcaktuese që si pasojë kanë orientuar drejt vendim-marrjes sikurse në dispozitiv të këtij vendimi kanë qenë çështjet e ngritura nga ana e ankuesit lidhur me eliminimin e tij si dhe pretendimet e ngritura ndaj të rekomanduarit për kontratë.

OE ankues është eliminuar nga ky aktivitet lidhur me dy arsye si në vijim:

Te përshkrimi i çmimeve ne paramasë është përdorur dy e me shume numra pas presjes dhjetore

Nuk kemi referenca sipas kërkesës se AK-se ne vlere prej 51%

Lidhur me arsyet e lartcekura të eliminimit, pas analizimit dhe shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, paneli ka arritur në konstatimin se lidhur me pikat e eliminimit të OE ankues nuk ka gjetur mbështetje të plotë me raportin e ekspertizës, duke u nisur nga fakti se legjislacioni në fuqi në të cilat palët janë thirrur, e poashtu kërkesa në DT që saktëson se te përshkrimi i çmimeve ne paramase ju referohet çmimeve të ofertuara nga OE pjesëmarrës, konkretisht kjo procedurë është

procedurë e hapur, furnizim pa sasi indikative ndërsa kemi të bëjmë me peshim të çmimeve dhe poentim të tyre, kështu që peshimi dhe poentimi nuk mund të konsiderohet si çmim i ofertuar por vlen të theksohet se peshimi i çmimeve shërben vetëm të vlerësimin e ofertave nga ana e AK-së, konkretisht edhe sipas Rregullore nr.001/2022 për prokurimin publik me nenin 27.14 saktësohet që:

“Funksioni i vetëm i peshimit të çmimit është që të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët, por pagesa gjithmonë kryhet në baze të çmimit të ofertuar. Çmimi total i poentuar (peshuar) lexohet gjatë procesit të hapjes së ofertave.”

Andaj duke u bazuar në dispozitën e lartëcekur, nga ana e panelit konsiderohet se çmimet e ofertuara janë çmimet e dhëna nga OE ankues si çmime për njësi, ndërsa në ofertën e tij të njëjtat nuk kanë përmbajtur më shume se dy (2) numra pas presjes dhjetore, e poashtu duke konsideruar argumentet e dhëna që çmimi i peshuar nuk është vendosur nga OE-të ofertues por është kalkuluar në bazë të formulës së paraqitur nga ana e AK-së, kështu që lidhur me këtë pretendim paneli konstaton se klasifikohet si i bazuar.

Lidhur me arsyen tjetër të eliminimit, ku i njëjti është eliminuar në lidhje me mos plotësimin e referencave të paraqitura që vërtetojnë kriterin e kërkuar në lidhje me kontratat e përfunduara vlerëson se OE ankues, në këtë pikë paneli mbështet mendimin e ekspertit për faktin se është e evidentueshme në bazë të dokumentacionit të paraqitur që OE ankues në kontratat e paraqitura ka ofruar kontrata të realizuara si dhe ngjashmëria e tyre me natyrën e aktivitetit relevant në parim nuk duket të ketë dallim substancial, megjithatë paneli konsideron se lidhur me këtë çështje AK ka mundur të kërkojë informata shtesë konform neneve 59 dhe 72 të LPP-së kjo duke u nisur poashtu nga fakti që në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim AK nuk është arsyetuar në mënyrë detale, konform nenit 108/a të LPP-së.

Lidhur me pretendimet ankimore të ngritura ndaj OE të rekomanduar për kontratë, pas analizimit dhe shqyrtimit të të njëjtave paneli ka arritur në konstatimin se mbështet të gjeturat e ekspertit dhe rrjedhimisht të njëjtat klasifikohen si pretendime të pa-bazuara (pa nevojën për tu ripërsëritur në detaje), për faktin se është e evidentueshme që nga lista e paraqitur të OE të rekomanduar, listohen kontratat që në esencë kanë ngjashmëri me natyrën e aktivitetit relevant, përveç faktit që edhe vetë OE ankues ka paraqitur kontrata shërbimesh, poashtu duhet theksuar se kërkesa në DT ka qenë që OE-të të paraqesin kontrata të ngjashme me natyrën e aktivitetit, dhe jo të njëjta duke nënkuptuar që nuk është kërkuar vetëm furnizime, këtu poashtu kemi të bëjmë me aplikimin e nenit 7, trajtimin e barabartë të palëve për faktin e gjendjes së ngjashme të OE ankues në raport me OE të rekomanduar, poashtu lidhur me certifikatat ISO, vlen të theksohet se të njëjtat përmbajnë përshkrimin për tregti produktesh andaj pretendimi se të njëjtat janë vetëm për shërbime nuk qëndron, ndërsa lidhur me çmimet abnormalisht të ulëta, vlen të theksohet se legjislacioni rregullues, konkretisht neni 61 i LPP-së i referohet dhe i jep diskrecionin AK-së që kur në dukje ofertat duken se përmbajnë çmime ab-normalisht të ulëta AK mund të kërkojë informata sqaruese, andaj poashtu duke qenë se OE ankues nuk ka paraqitur dëshmi, fakte dhe argumente bindëse se kontrata do të mund të rrezikohet në implementim, paneli vlerëson se AK në rast dyshimi poashtu mund të përdorë instrumentet ligjore siç janë rritja e sigurimit të ekzekutimit, ndërsa poashtu lidhur me qasjen dhe sekretet afariste, mungesa e qasjes tek mostrat mund të arsyetohet për faktin se të njëjtat nuk kanë qenë të identifikueshme, ndërsa kjo poashtu rregullohet me nenin 10 të LPP-së ku përgjegjësia i dedikohet AK-së në aspektin e konsiderimit të sekreteve afariste, kështu që përfundimisht lidhur me pretendimet ndaj OE të rekomanduar për kontratë, paneli mbështet raportin e ekspertit në këto pika si dhe konsiderohet se OE ankues nuk

ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme që të bindin panelin që lënda të kthehet në rivlerësim, andaj rrjedhimisht përgjegjësia e plotë i takon AK që të veprojë konform legjislacionit në fuqi, ashtu siç është e përcaktuar edhe me nenin 24.2 të LPP.

Paneli shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktuese janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - NTP " BENI "**
- Arkivës së OSHP-së: